



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____, Prot.

Tiranë, më _____. 2024

Lënda: Përcjellje për kompetencë

Pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor është përcjellë kërkesa për informacion e z. {...} regjistruar me numër rendor 42 në regjistrin përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve, si dhe me aktin nr. 4672 prot., datë 27.09.2024, në të cilën ka kërkuar informacion mbi datën dhe orën e seancës së procesit disiplinor që po zhvillohet ndaj një nëpunësi civil gjyqësor pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë.

Bazuar në nenin 69, pika 2, shkronja b), të ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në Rregulloren për zhvillimin e procedurave disiplinore për nëpunësit civilë gjyqësorë, miratuar me vendimin nr. 22, datë 24.01.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, organi kompetent për zhvillimin e procedurës disiplinore dhe caktimin e masës disiplinore për nëpunësit e tjerë civilë gjyqësorë është Këshilli i Gjykatës.

Sa më sipër, lutemi vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar nga z. {...} lidhur me datën dhe orën e zhvillimit të procesit disiplinor përkatës.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin, bashkëlidhur gjeni një kopje të shkresës nr. 4672 prot., datë 27.09.2024.